

RUDOLF STEINER

**PASHKA FESTË E
PARALAJMËRIMIT**

Përkthue: Valdet FETAHU

Ligjërimi i parë nga cikli i shtatëmbëdhjetë ligjërimeve:

Ndodhia para Damaskut dhe njohja e re shpirtërore

Prej kohërave të lashta të krishterimit është aplikuar zakoni të dallohet Krishtlindja prej Pashkës me atë që Krishtlindja shtë caktuar si festë e palëvizshme, është vërë në ditën e cila vjen disa ditë pas 21.dhjetorit, saktësisht llogaritjes dimërore të kohës dhe që Pashka është konsoliduar në ditën e cila është caktuar me konstelacionin-(*lat. Kon...+ stella* – yll. 1.Pozita reciproke e trupave qiellor; grumbulli i yjeve që krijojnë figura të pavarura në kupën qiellore)e yjeve, por me konstelacionin e yjeve të cilat njëkohësisht deri diku bashkojnë jashtëtokësorën dhe qenien njerëzore dhe tokësore. Nesër do të jemi në shenjën e hënës së plotë të parë pranverore dhe në këtë hënëplotë pranverore do të shkëlqej dielli pranveror i cili pas 21 marsit ka hyrë në shenjën e pranverës. Pra kur njerëzimi përsëri feston javën e parë, ajo ditë e cila duhet ta përkujtojë për lidhjen e tij me fuqinë diellore, javën e cila është java e parë pas hënës së plotë pranverore, atëherë sipas teorisë krishtere mbi jetën duhet të festohet Pashka. Pashka është festë lëvizëse. Sikur është e nevojshme që përçdo vjetë ta shikojmë konstelacionin në qiell për t'u paralajmëruar se kur vjen Krishtlindja.

Këto gjëra janë konsoliduar kur ende nga aftësitë profetike ataviste kanë ekzistuar kuptueshmëritë urtake, kuptueshmëri të cilat njeriut i kanë ofruar njohuri, njohuri të atilla të cilat me të madhe e tejkalojnë njohurinë të cilën sot ofron shkenca moderne. Në ato kohëra të lashta derisa ka ekzistuar ajo njohuri, njeriu ka anuar që lidhshmërinë e tij me qiellin ta shpreh përmes gjërave të tilla. E në festa të tilla të konstituara gjendet gjithmonë paralajmërimi në atë më të rëndësishmën për zhvillimin e njerëzimit.

Mund të themi, çasti i palëvizshëm në të cilin vendoset Krishtlindja tregon se sa afër duhet të ndjehet Krishtlindja me atë tokësore, pasi që duhet të përkujtojë në lindjen e njeriut mbi të cilin ka zbritur qenia e Krishtit. Por Pashka duhet të përkujtojë në ngjarjen e cila ka kuptim gjatë rritjes tokësore por në gjithë kozmosin, me të cilin njeriu është në lidhshmëri. Për këtë arsye dita kur duhet të vendoset Krishtlindja nuk udhëheqet vetëm nga situatat e zakonshme tokësore, por dita e cila mund të konsolidohet vetëm kur njeriu mendimet e veta i orienton jasht në qiell. Edhe diçka edhe më thellë gjejmë në atë ditë të lëvizshme të konsoliduar të Pashkës. Në këtë gjendet mënyra se si njeriu përmes impulsit të Krishtit duhet të çlirohet nga rritja tokësore, nga forca e pastër tokësore; se duhet të bëhet i lirë përmes njohjes qiellore. Kur një thirrje për t'u ngritur deri tek qielli, ajo gjendet në të. Dhe mund të themi: Në të gjendet edhe premtimi i

sigurtë i historisë botërore dhënë njeriut se ai përmes impulsit të Krishtit mund të çlirohet nga situatat tokësore. Nëse dëshirojmë plotësisht të shohim se çka shprehet në atë datë të konsoliduar të karakterizuar (përshkruar) të Pashkës, mund të vështrojmë në misteret e para të krijimit të krishterimit misteret e para të cilat më shumë e më pak gradualisht për një kohë të caktuar janë fshehur nga botëkuptimi materialist i botës, e cila është futur në zhvillimin e njerëzimit nga fillimi i epokës së pestë postatlantide dhe e cila prej tash do të mbizotërojë me kuptueshmëri. Për të shikuar sesi në ato situata përgjigjet, nevojitet ta shohim sesi në zhvillimin e impulsit të Krishtit në ekzistimin historik të njerëzimit përfshihet figura e apostullit Pal. Na duhet vetes gjithmonë rishtazi t'ia çojmë para shpirtit atë sesi pikërisht figura e apostullit Pal përfshihet në zhvillimin e krishterimit. Mund të themi: Pali ka pasur shumë raste që me vështrim, me vështrim të jashtëm fizik të informohet për ngjarjet në Palestinë të cilat kanë të bëjnë me personalitetin e Jezusit, përmes krejt atyre që në botën fizike kanë vepruar mbi të, Pali nuk është bindur, - sepse ai akoma ka qenë në anën e atyre të cilët e kanë luftuar krishterimin, pasi që veq kanë përfunduar ngjarjet në Palestinë. Pali është bërë apostull krishterimi tek pasi që ka përjetuar ndodhinë para Damaskut, pasi që ka përjetuar thelbin e impulsit të Krishtit, përmes qiellores, përmes metafizikës. Pikërisht Pali është ai i cili përmes mbresave fiziko-epshore nuk ka mundur të bindet për kuptimin e impulsit

të Krishtit por iu është dashur, për t'u bindur, përvoja metafizike. E ajo përvojë metafizike rrënjësisht ja ka ndryshuar Palit jetën. Ajo ka qenë aq vendimtare sa që Pali është bërë plotësisht njeri tjetër. Më në fund mund të themi: ajo ka qenë aq e thellë sa që Pali është bërë ai të cilin mund ta quajmë të vetmin të ndritur.

Pali ka qenë mirë i përgatitur për ta përjetuar atë. Ai ka qenë njohës i mirë i fshehtësive religjioze izraelite dhe botëkuptimin izraelit, dhe ai përmes asaj dije të tij ka qenë mirë i përgatitur ta gjykoj ngjarjen e cila iu ka fanitur si ngjarje para Damaskut. Ka qenë mirë i përgatitur që në atë ngjarje mund t'i thotë vetes atë që në atë ngjarje mund t'i jep një vështrim të sakt, një ide të sakt. Mund të themi, vetëm një reflektim të asaj që Pali me të vërtetë ka përjetuar në qenien e tij, hasim në atë që është e njohur si letrat e Palit. Aty gjithsesi gjejmë se ai për ngjarjen para Damaskut flet si njeri i cili përmes asaj ngjarjeje ka fituar njohuri mbi ndodhitë në botë, të cilat janë prapa vellos së botës epushore. Aty shohim se ai flet në atë mënyrë për t'a njohur se ai mund të gjykojë për botën krejtësisht të ndryshme metafizike sesa që është kjo botë fizike.

Kur edhe vetëm nga jashtë krahasojmë jetën e Palit me përjetimin e jashtëm tokësorë të Jezu Krishtit, hasim në diçka shumë të rëndësishme, diçka që zbardhet vetëm atëherë kur sipas pikëpamjeve shpirtërore-shkencore, në harmoni me realitetin kemi parasyshtë zhvillimin e njerëzimit. Në lidhje me këtë më shpesh jua kam tërhequr

vërejtjen për atë sesi njeriu në kohërat tjera ka qenë kreytësisht i ndryshëm në pikëpamjen e zhvillimit të tij organiko-shpirtëror dhe sesi është bërë tjetër gjatë zhvillimit të tij prej kohës së civilizimit indius, persian, egjiptaso-haldeje, greko-latine deri në ditët tona. Në të vërtetë kur vështrojmë në të shkuarën zhvillimi i njerëzimit – për këtë shpesh kemi folur – hasim në atë sesi njeriu deri në pleqërin e tij ka mbetur organikisht i aftë për zhvillim, sesi njeriu deri në pleqëri ka kaluar nëpër etapa të ngjajshme paralaliste ndërmjet zhvillimit të tij shpirtëror dhe atij fizik, si sot që kalohet nëpër të vetëm me rritjen e dhëmbëve, me pjekurinë seksuale, me moshën njëzet vjeçe. Këtë njerëzimi e ka humbur në dukjen e tij të përgjithshme që në moshën e shtyer të përjetoj transformime të tilla zhvëllimore. Deri në moshën pesëdhjetë vjeçe në epokën induse, deri në moshën dyzetë vjeçe më vonë në epokën persiko-egjiptase, deri në moshën 35 vjeçe në epokën greko-latine, njerëzit e atyre kohërave të lashta kanë përjetuar paralelizmin në mes zhvillimit shpirtëror dhe fizik. Ne e përjetojmë paralelizmin e tillë, siç e kam e theksuar shpesh deri në moshën 27 vjeçe dhe ajo që bëhet në moshë të shtyer vështirë mund të vërehet. Në kohën kur impulsi i Krishtit ka hyrë në zhvillimin e njerëzimit, atëherë ka qenë pikërisht ashtu që njerëzit, dhe njerëzit e popullit greko-latinë, kanë përjetuar atë paralelizëm deri në moshën 33vjeçe. E Jezu Krishti i ka jetuar ditët e veta fizike në tokë pikërisht aq gjatë sa që për atë kohë të

ditëve tokësore fizike ka kaluar nëpër atë jetë e cila rrjedhë në paralelizëm ndërmjetë rregullimit fizik dhe atij shpirtëror. Mandej gjatë jetës tokësore ka kaluar nëpër dy vdekje. Çfarë do të thotë ky kalim nëpër dy vdekje, kjo mund të mësohet vetëm përmes një këndvështrimi shpirtëroro-shkencor, siç e kam elaboruar shpesh; kjo mund të njihet vetëm kur njeriu mund të shikojë në botat metafizike. Sepse kjo nuk është ngjarje e cila mund të kuptohet përmes asaj që ngjanë në botën eposore.

Pali si njeri fizik ka qenë përafërsisht i vjetër sa edhe Jezu Krishti. Ai pikërisht atë kohë e ka kaluar në antikrishtim kohën kur Jezu Krishti e ka kaluar në veprimin e tij tokësor. E pjesën tjetër të jetës Pali e ka jetuar nga ajo që ka përjetuar prej përvojës metafizike. Në pjesën tjetër të jetës ka përjetuar përmes përvojës metafizike atë që (si) njeri më nuk ka mundur ta përjetojë në pjesën tjetër të jetës përmes përvojës metafizike, pasi që njeriu deri në ato vite të vona tokësore mbi 35 vjeç ka përjetuar edhe ndonjë paralelizëm ndërmjetë zhvillimit shpirtëror dhe zhvillimit fizik. E ngjarja në Golgotë iu ka shfaqur Palit në atë mënyrë – që përmes ndritjes direkte ka ardhur kuptueshmëria të cilën disa njerëz veç e kanë poseduar përmes praurtësisë në mënyrën ataviste; të cilën njerëzit e kohës moderne mund ta arrinë vetëm përmes një shkence të re shpirtërore; e cila Palit për këtë arsye iu është dhuruar për të qenë në gjendje të bëhet iniciator për një kuptueshmëri të drejtë të asaj e cila përmes impulsit të Krishtit i ka ngjarë njerëzimit.

Përafërsisht sa gjatë Krishti ka banuar në tokë, po aq edhe Pali ka jetuar më tutje, diku rreth 67-68 vjet jete, që ai vetë po aq gjatë (sa ka banuar Krishti në tokë) ta themelojë shkencën mbi krishterimin në zhvillimin tokësor. Është paralelizëm i rëndësishëm në mes jetës së Jezu Krishtit dhe jetës së Palit. Vetëm se jeta e Jezu Krishtit ka qenë i plotësuar me ekzistimin e brendshëm Krisht, derisa tek Pali ka ekzistuar një përjetim i më vonshëm i ndritjes të asaj ngjarjeje aq fuqishëm sa që ai ka qenë në gjendje, si i pari në njerëzim, të ofrojë pamje të sakt mbi krishterimin – në atë gjatësi kohore e cila përafërsisht i përgjigjet jetës së Jezu Krishtit në tokë. Të vështrohet lidhja në mes asaj që është në zhvillimin e njerëzimit në tokë dhënë jetës së Jezu Krishtit dhe asaj që Pali ka mësuar në qenien e Krishtit, të vështrohet kjo lidhje në mënyrë të drejtë, do të thotë në të vërtetë për njeriun është shumë e rëndësishme. Vetëm na duhet ta përjetojmë atë lidhje ashtu që ajo me të vërtetë të shfaqet si rezultat i ndikimit metafizik të cilin e ka përjetuar Pali. E kur teologjia e re ka shkuar aq largë sa që ndodhinë para Damaskut e ka shpallur si një lloj halucinacioni, si një lloj iluzioni, e kjo dëshmonë se edhe teologjia e re ka hyrë në materializëm, dhe se as teologjia moderne nuk e njih më esencën e botës metafizike dhe vlerën e kuptueshmërisë së botës metafizike për ta kuptuar thelbin e krishterimit.

Në të vërtetë njeriu duhet vetes t'ia pranoj, t'ia pranoj plotësisht me seriozitet dhe ndershëm se është vështirë të

familjarizohet me imazhe krejtësisht të ndryshme, të ndryshme nga të sotit – të cilat gjenden në Ungjill dhe në letrat e Palit. Por njeriu është mësuar se më kurrsesi të mos llogarisë me imazhe të tilla. Në esencë njeriu i cili plotësisht është i plotësuar me imazhe të zakonshme të së sotmes, shumë është largë që vetes t’ia imagjinoj atë të vërtetën në fjalët e Palit. A nuk po përpiqen numër i madhë i teologëve të sotit që ndodhinë parta Damaskur ta kuptojnë sa është e mundur ma shumë në mënyrë materialiste; teolog të caktuar përpiqen madje, derisa pohojnë se janë krishter të vërtetë, angazhohen rreth asaj ta mohojnë ringjalljen e vërtetë të Jezu Krishtit! Me këtë këto personalitete vetëm dëshmojnë se ata nuk janë të prirur që cilëndo njohuri metafizike ta aplikojnë në esencën e krishterimit, në paraqitjen e Jezu Krishtit në zhvillimin tokësor. Që figura e Palit qëndron në majen e traditës krishtere, pra që qëndron figura e njërit të cilit përmes përjetimeve metafizike ka arritur deri tek njohja e krishterimit. Kjo është si një thirrje që i dërgohet njeriut për t’iu afruar njohjes metafizike. Kjo është deri diku deklarat mbi atë se është e pamundur të kuptohet krishterimi nëse nuk i qasemi njohurive të cilat janë të nxjerrura nga burimi i metafizikës. Nevoitet që figurën e Palit ta kuptojmë si njërin nga të përkushtuarit në lidhjen metafizike të botës. Është e domosdoshme që në atë dritë ta shohim atë të cilën ai është munduar t’ia ofrojë njerëzimit. Le të provojmë që në gjuhën moderne t’ia

çojmë vetes para shpirtit diçka nga ajo që, siç duket, ka qenë pikërisht më e rëndësishmja Palit të ndritur.

Për Palin ka qenë personalisht e rëndësishme të informojë për këndëvështrimin plotësisht të ri të njeriut ndaj zhvillimit të botës e cila ka ardhë përmes impulsit të Krishtit. Për të ka qenë e rëndësishme të thotë: Zhvillimi i botës në të cilën janë përfshirë përjetimet e vjetra pagane, kanë marrë fund për njeriun; përjetimet e reja të jetës shpirtërore janë këtu; njeriut i duhet vetëm t'i shikojë. Me këtë Pali veç ka treguar për atë çarje të thellë në rritjen tokësore të njeriut në të cilën, gjithmonë rishtazi duhet informuar, nëse dëshirojmë ta njohim historinë e vërtetë. Kur shikojmë në të shkuarën në zhvillimin e parakrishtimit, dhe atë në ato kohëra të cilat kanë qenë në mënyrë të veçantë të karakterizuara, pasi që radikalisht kanë pasur vetitë më të theksuara të parakrishtimit., mund të themi: ajo ka qenë shikim plotësisht-i ndryshëm i njeriut. E sigurtë se në një moment nuk është shfaqur ndryshimi i plotësishtëm, por prapë ngjarja në Golgotë është një, që tregon se si një fazë në zhvillimin e njerëzimit ndahet nga faza tjetër. Ngjarja në Golgotë është vendos në fund të këtij zhvillimi në të cilën njerëzit, duke shikuar botën materiale, kanë shikuar edhe botën shpirtërore. Pavarsisht sesa e largët është kjo njeriut modern, pavarsisht sesa e pabesueshme i duket kjo njeriut modern – në kohën parakrishtere njerëzit sipas zakonisht në botën materiale kanë shikuar edhe botën shpirtërore. Kanë shikuar jo

vetëm drunjët jo vetëm bimët, në drunjë kanë parë edhe atë shpirtërore, në bimë gjithashtu. Por kultura në atë vështrim kishte marrë fund kur është afruar misteri në Golgotë. Një elementi i ri është nevojitur të përfshihet në zhvillimin e njerëzimit. Kur njeriu në mjedisin e tij sheh shpirtërorën në gjërat fizike materiale, - nuk mundet që vetëdija e tij të bëhet e atillë që në të të krijohet impulsi i lirisë. Me krijimin e atij impulsi të lirisë duhet të jetë në lidhshmëri deri diku të le postulatit hyjnor-shpirtërore kur shikon vetëm në botën e jashtme. Me atë impuls të lirisë duhet të jetë në lidhshmëri e domosdoshmja nga forca më e thellë e shpirtit të cilën e nxjerrim kur vështrojmë shpirtërorën.

Kjo është diçka nga ajo që pikërisht Pali ka dashtë me ia shpalë njerëzimit, se në kohën kur njerëzit kanë qenë vetën fise të Adamit(Ademit), se në ato kohëra të lashta nuk ka pasur nevojë që njerëzit nga brendia e tyre ta nxjerrin përjetimin aktiv për ta parë të hyjnishmën dhe shpirtërorën, pasi që me të gjitha ato që kanë jetuar në qiell dhe tokë është shfaqur ajo hyjnor-shpirtërore si demonike. Por njerëzimi duhet ta arrijë – apo të paktën gradualisht të vijë tek ajo se duke jetuar në fanitjen materiale të shikojë në hyjnor-shpirtërorën. Dhe është nevojitur të afrohet koha kur njeriut i nevojitet që me të brendshmen e tij aktive të forcoj veten e tij me të dhe tek mandej të ngritet deri tek e hyjnishmja dhe shpirtërorja. Ka qenë e domosdoshme që njerëzimi të mësojë t'i kuptojë fjalët: “Mbretëria ime nuk është nga kjo botë”.

Nuk është duhur të mbetet që njerëzimi ta mbajë të hyjnishmën dhe shpirtërorën e cila dëshiron të ngritet nga fanitja e pshore. Ka qenë e nevojshme që njerëzimi të gjej rrugën deri tek hyjnorja – mbretëria shpirtërore e cila duhet të burojë nga e brendshmja, të arrihet me zhvillimin e (qenies) së brendshme. Njerëzit sot e kuptojnë Palin aq trivialisht, pasi që gjithmonë rishtazi e zhvillojnë prirjen që atë të cilën ai e ka thënë ta përkthejnë në gjuhën e tyre, në gjuhën e materializmit modern. E kuptojnë në mënyrë aq triviale, sa që do ta quajnë të marrë çdonjërin i cili i përkushtohet fjalëve të Palit, por të cilat plotësisht janë të vërteta. Pali e ka ndije si krizë të madhe botërore atë që si në perëndim është zhdukur e vjetra, vështrimi e pshoro-shpirtëror, dhe që është duhur të paraqitet si në një mbretëri e re e dritës të vështrimit shpirtëror, e cila do të dilte në pah me iniciativën e brendshme, e cila nuk është e dhënë në të njëjtën kohë me vështrimin e pshor. Pali e ka ditë në bazë të përjetimit të tij metafizik të pos-fejesën që Jezu Krishti pas ringjalljes gjithmonë është i bashkuar me zhvillimin tokësor të njerëzimit. Por ai gjithashtu e ka ditur, edhe pse Jezu Krishti banon në tokë, ai mund të takohet vetëm përmes angazhimit të forcave profetike të brendshme, e jo vetëm me vështrimin e pshor. Ai i cili dëshiron të mbërri tek Jezu Krishti vetëm përmes vështrimit e pshor, ai mashtrohet me këtë, duhet të jetë se ai ndonjë demon e konsideron si Krisht.

Kjo ka qenë ajo të cilën Pali gjithmonë rishtazi e ka paraqitur, plotësisht sigurtë këtë ua ka thënë atyre të bashkësisë së tij të cilët për këtë kanë qenë të aftë, se me vështrim të vjetër shpirtëror nuk duhet t'i afrohen Krishtit: se aty me siguri njeriu ndonjë qenie të rreme do ta konsiderojë Krisht. Për këtë arsye Pali është përpjekur që njerëzit t'i largoj nga vështrimi i qenieve shpirtërore(demon) të qiellit dhe tokës të cilët kohëve të vjetra iu kanë qenë mirë të njohura, pasi që pikëpamjet e tyre kanë qenë të prapambetura akoma ataviste, e për më tutje aftësi të pavlerë(të paarsyeshme). Për këtë arsye Pali është bërë i palodhshëm që gjithmonë rishtazi t'i përkujton njerëzit ta zhvillojnë atë forcë në veten e tyre, me zhvillimin e të cilës mund të arrihet kuptueshmëria mbi atë se në zhvillimin e botës ka ardhur impulsi plotësisht i ri, qenie plotësisht e re. ai thotë: “Krishti përsëri do t’ju vjen nëse vetëm e gjeni rrugën të dilni jashtë nga vështrimi i pastër fiziko-epshor të tokës. Krishti përsëri do t’ju vjen, sepse ai është këtu. Por për JUVE ai përsëri duhet të vijë. Ai është KËTU përmes ndodhisë në Golgotë. JU duhet vetëm ta gjeni.”

Kjo është ajo të cilën Pali e ka deklaruar në gjuhën e tij në gjuhën e cila në atë kohë ka tingëlluar shpirtërisht krejtësisht ndryshe sesa ajo që sot njerëzit në jehonën e natyrës e përkthejnë atë të cilën atyre iu pëlqen, e cila krejtësisht ndryshe ka tingëlluar sesa sot që tingëllon nga letrat e Palit. Kjo është ajo të cilën Pali gjithmonë rishtazi ka dashtë ta zgjojë si bindje tek njerëzit. Ka dashtë ta

zgjojë bindjen: Kur njeriu dëshiron ta kuptojë Krishtin i nevoitet një tjetër vështrim sesa që është vështrimi i cili mjafton për botën epshore. Përkundër kësaj, miq të mi të dashur, njerëzimi i sotit ka shkuar aq largë sa që dorën në zemër akoma flet për kundërshtitë e njëfarë shkence dhe feje të jashtme epshore. Shekencës së jashtme epshore teologjia ja lejon të bëhet e ndërlikuar, të bëhet profesionale, të jetë e udhëzuar në atë se diçka mëson; fesë ajo këtë nuk ja lejon. Feja duhet – siç theksohet përsëritet gjithmonë të apelohe në atë më fëmijërore në njeriun, mbi atë për të cilën nuk duhet asgjë të mësojmë.

Pikërisht me këtë e ka marrë karakterin e vet ajo pikëpamje e cila e mohon ngjarjen para Damaskut si përgjigje e tillë ndaj realitetit, dhe e cila ndodhinë para Damaskut dëshiron ta konsiderojë vetëm si diçka që ka qenë një lloj halucinimi i Palit. Gjithashtu mund të them: nëse ngjarja para Damaskut ka qenë ajo e cila tek një numër i madh i teologëve modern duhet të jetë ngjarja para Damaskut, atëherë duhet me qenë i guximshëm dhe të thuhet: duhet të mohohet krishterimi sa ma shpejtë që është e mundur, sepse atëherë marrëzia më e madhe është t'i predikohet njerëzimit krishterimi.

Kjo është ajo e cila në të vërtetë sipas mësimëve të reja teologjike është e domosdoshme kur njerëzit këto mësimë të reja do t'i konsideronin, së pari seriozisht dhe e dyta, mjaft guximshëm; por ata nuk i marrin as seriozisht e as guximshëm. Ata largohen nga njohuria e jashtme epshore, mohojnë impulsin e brendshëm real

para Damaskut, por prapë fortë janë të lidhur me krishtimin. Pikërisht në këto gjëra shprehen qartë dëmet e brendshme shpirtërore-intelektuale të kohës sonë; sepse në gjëra të tilla shfaqet gënjeshtria e brendshme e thellë e kohës sonë. E vërteta duhet vetes t'ia pranojë: ja ngjarja para Damaskut ka qenë realitet i qartë, diçka që ka të bëjë me realitetin, atëherë krishtimi ka kuptim; apo ngjarja para Damaskut ka qenë e tillë siç pohon teologjia moderne, e cila dëshiron t'i afrohet shkencës moderne – atëherë krishtimi s'ka kurrfarë kuptimi. Kjo është shumë me rëndësi, që njerëzit gjërat e këtilla t'ia vëjnë vetes para shpirtit në këtë kohë moderne, e cila në të vërtetë është kohë e sprovës së madhe! Sepse me atë që njerëzit para vetvetes janë bërë gënjeshtar në pikëpamjen e gjërave të veta më të shenjta, me atë që janë bërë gënjeshtar në atë kuptim sa më nuk guxojnë ta quajnë krishtim atë që ata e konsiderojnë, e ka përfshirë prirjen e njerëzimit, shpesh pavetëdijshëm por s'do të thotë se ndryshon prirja e dëmshme kah e pavërteta. Për këtë arsye ky anim kah e pavërteta aq është e brendshme në lidhje me ndodhitë të cilat prej tash duhet të çojnë deri tek dekadencia e plotë e jetës kulturore evropiane, nëse, për atë jetë kulturore evropiane, njerëzit në kohën e duhur nuk vetëdijesohen të orientohen nga njohja shpirtërore.

Për t'u orientuar njerëzit ka njohja shpirtërore, kjo prapë nuk mjafton, me të vërtetë në këtë kohë të sprovës së vështirë, të qëndrohet në diçka të vogël, përkundrazi për

këtë mjafton vetëm, nëse gjërat me të vërtetë merren nga thellësitë e tyre, dhe të mendohet për transformime të mëdha pikërisht në kohën tonë. Gjithmonë rishtazi duhet të theksohet: e cila prapë, marrë në esencë është festë e tillë, siç është Pashka, për një numër të madh të njerëzve? Kur afrohet Pashka për një numër të madh njerëzish, të parët e festojnë Pashkën në gjirin e atyre të cilët dëshirojnë ta festojnë Pashkën, ka mendime mbi atë se njerëzit dëshirojnë t'i mbajnë mënyrat e vjetra të menduarit, dhe të flasi në një masë të madhe në mënyrë të vjetër, pak a shumë në mënyrë automatike akoma flasin, të recitojnë formula të njëjta, pasi që rreth nesh gjithandej vërejmë se nuk ekziston vullneti për të marrë pjesë në transformimin e madh të domosdoshëm të kohës. A mundemi me të drejtë të thirremi në fjalët e Palit: “Jo unë por Krishti në mua”, kur jemi aq pak të prirur të shikojmë në atë se çka e ka shpjer njerëzimin në fatkeqësi të madhe gjatë kohës moderne? A nuk duhet të mos kemi dilema se pikërisht Pashka ka qenë ajo që i ka ngjarë njerëzimit, dhe mbi atë se pikërisht kjo mund ta shpëtoj nga katastrofa: e ajo është njohja metafizike! Nuk do të duhej, kur Pashka kur në kuptimin e vet bazohet në njohjen metafizike – sepse kurrë më nuk mundet ajo që do të thotë Pashka Ringjallja e Jezu Krishtit, të ketë kuptim vetëm njëfarë njohje epshore nuk do t'i duhej njerëzimit, po të merrej Pashka seriozisht, të mendoj për atë se metafizika prapë duhet të hy në mësimin e njeriut? Nuk do të duhej që sot të buroj mendimi: gënjeshtër e

kulturës moderne ka shkuar deri atje sa na vetë më nuk e kemi konsideruar seriozisht atë që i pranojmë si festa tona të shenjta?

E festojmë pashkën, festën e ringjalljes, e moti kohë e kemi braktisur, në bazë të idesë materialiste, se dëshirojmë me seriozitet ta kuptojmë ringjalljen. Plotësisht jemi në armiqësi me të vërtetën dhe i kërkojmë të gjitha daljet e mundshme, në vend se nga e vërteta, të shkojmë tek të gjitha zbatimet e mundshme të botës; argëtim botëror, sepse ashtu do të quhej apo ashtu veç quhet, ajo kur njerëzit festojnë festën e ringjalljes derisa i besojnë shkencës moderne e cila, vetvetiu kuptohet, nuk mund të thirret kurrsesi në ringjallje. Materializmi dhe festa e Pashkës, duhet të jetë e pamundur që këto dy gjëra të jenë së bashku, se është e pamundur që njëra të jetë pranë tjetrës. As metarializmi i teologëve modern nuk pajtohet sot me Pashkën. Jetojmë në kohën kur një teolog me renome më të madhe në Evropën qendrore shkruan (veprën) “Esenca e krishtimit” në të cilën është bërë e mundur që kjo “Esencë e krishtimit” të vlerësohet si diçka jashtëzakonisht e rëndësishme. E në atë “Esencë të krishtimit” hasim në përpjekjen e plotësishme të mos merret seriozisht realiteti i ringjalljes së Jezu Krishtit! Kjo e karakterizon kohën tonë.

Kjo prapë është diçka, për të cilën ndjenja e thellë duhet të futet në zemrën, në shpirtin e njerëzimit modern. Por ne nuk do të dalim nga mjerimi, nëse nuk zhduket sakt ndjenja mbi armiqësinë të cilën njerëzimi modern

kultivon ndaj të vërtetës, nëse me të vërtetë nuk pihen gjërat të cilat fundamentalisht në jetë kanë vlerë aq të madhe.

Nevoitet që ajo tendencë e cila është shfaqur në periodën e pestë postatlatide: tentativa për një njohuri shkencore të kuptueshme, e cila është e përshtatshme për forcën e gjykimit njerëzor, që kjo tentativë të hy në njohuritë e botës metafizike. Sepse në ndodhitë që gjenden në botën metafizike është edhe ngjarja në Golgotë. Në ndodhitë, të cilat mund të kuptohen vetëm përmes paraqitjes metafizike, është edhe ngjarja para Damaskut të cilën Pali e ka përjetuar. Nga kuptueshmëria e kësaj ngjarjeje varet se a me të vërtetë nuk mund të ndiejmë asgjë nga impulsi i Krishtit. Pikërisht njeriu modern duhet vetes t'ia paraqet një provë, duke e pyetur veten: si unë qëndroj në kohën kur është kryqëzuar me “kremtimin e Pashkës”, çfarë qëndrimi kam ndaj njohjes metafizike? Sepse Pashka sipas asaj sesi përcaktohet dita, kur festohet Pashka, duhet ta përkujtoj njeriun për vështrim nga ajo tokësore kah ajo qiellore. Në pikëpamjen e vështrimit në qiell njeriu modern nuk i ka ruajt vetes asgjë përpos matematikës më të lartë. Mekanikës apo edhe në kohët e fundit analizën e spektrit. Këto janë baza përmes të cilave njeriu dëshiron të fitoj njohuri mbi jashtëtokësorën. Njeriu sot nuk ka kurrfarë ndjenje se është në lidhshmëri me atë qiellore dhe se ajo ajo qiellore ka zbritur Krishti në personin Jezus.

Miq të mi të dashur pikërisht tani pranoni vetëm seriozisht mendimet këtu të cekura. Shpesh ju kam paralajmëruar sesi nga natyra e mirë intelektuale, siç është Herman Grim, e kanë quajtur teoria e Kant-Laplasit, e cila sot deri diku është ndryshuar, por në esencë akoma ka mbetur e njëjtë. Nga një mjegullnaj ka buruar ky sistem diellor; gjatë ndryshimeve të mjegullnajës dhe ngjeshjes së saj janë krijuar bimët, shtazët por dhe njeriu! E mandej në vazhdim pasi që të vdes çdogjë në tokë, dhe asgjë më nuk do të tingëllojë në kozmos nga ajo që kanë fantazuar njerëzit si ideal, si vepër kulturore – toka si një top do të bie në diell – e mandej në kohë edhe më të largët edhe dielli do të shkapërderdhet në gjithësi dhe jo vetëm se do të varroset por do të shkatërrohet çdo gjë që njerëzit kanë krijuar: kjo është një pikëpamje mbi rregullimin e botës i cili nuk ka mundur të jetë ndryshe në një kohë në të cilën dëshirojmë që qielloren ta kuptojmë vetëm me mësimet matematikore, mekanike. Nga një botë prej të cilës vetëm llogarisim, apo në të cilën vetit e Diellit i analizojmë me spektërskop, në një botë të tillë gjithsesi nuk mund të kërkohet vend në të cilin ka zbritur Krishti për t'u bashkuar me jetën në tokë! Një pjesë e caktuar e njerëzimit, pasi që nuk mundet me mendimet e veta të supozojë më me ëndje që askush të mos merret me këtë, por edhe më tutje flasin me ato fjalë të cilat i kanë mësuar në Ungjill, nga letrat e Palit, të përsërisin atë që kanë mësuar, duke mos menduar se a pajtohen me atë që

kanë arritur në pikëpamjen e zhvillimit të tokës dhe njerzimit. Por pikërisht këtu qëndron e pavërteta e brendshme e thellë e kohës sonë që njerëzit i ikin të mendojnë mbi atë se çka është me të vërtetë njëra pran tjetrës që pakushte të mendojnë për të. Njëfarë mjegulle njerëzit dëshirojnë ta krijojnë para vetes për të mos menduar se çka i përketë te dyjave. Për këtë arsye krijojnë edhe njëfarë mjegulle para vetes edhe kur festojnë festa, kur flasin për Pashkët, për festën e ringjalljes, e në të vërtetë janë largë nga ajo që vetes t'ia krijojnë një ide mbi ringjalljen, e cila sot mund të krijohet vetëm me mesime shpirtëro-ro-metafizike.

Më në fund një është e mundur për njeriun modern të ketë një ndjenjë për Pashkën kur mendon mbi atë se si në kohërat tona ka ardhur në të vërtetë një katastrofë botërore, për të cilën nuk mendojmë vetëm në katastrofën botërore e cila ka ngjarë në vitet e fundit të luftës, por me këtë nënkuptojmë atë katastrofë botërore e cila ka të bëjë me atë se njerëzit i kanë harruar imazhet mbi përfytyrimet tokësore dhe qiellore. Më në fund është e domosdoshme që njerëzit e të sotmes t'i sigurojnë vetes qartësi mbi atë, vetëdije mbi atë se nga ai varr, nga varri i kënvështrimit materialist, duhet të ringjallet njohja metafizike. Sepse me mesime metafizike ringjallet nga ai varr njohja mbi Jezu Krishtin. Dhe marrë në esencë sot nuk kemi simbol më të mirë i cili i përshtatet për Pashkë sesa kjo: i gjithë fati i shpirtit të njeriut është i kryqëzuar në këndëvështrimin materialist të botës. Por vetë njeriu,

njerëzimi, duhet të bëj diçka që nga varri i materializmit të ringjallet ajo që mund të vijë nga mësimi metafizik. Edhe vet animi nga njohja metafizike është diçka më e avansuar, ajo është diçka më tepër, kur ndjehet se përsëri iu ofron njerëzve të drejtën për ta festuar Pashkën. Kur e shikoni hënën e plotë dhe dëgjoni sesi ajo hënë e plotë në fazat e veta është e lidhur me njeriun, si reflektim i dritës së diellit me vetë hënën, a mendoni atëherë se vetë njerëzimi modern duhet të kërkojë një njohuri mbi njerëzimin, një njohuri të njerëzimit, përmes të cilës njeriu paraqitet si reflektim i vërtetë i metafizikës. Po e njohu njeriu veten si reflektim metafizik, po e njohu njeriu veten në atë se kush është, si i edukuar nga metafizika, atëherë e gjenë rrugën deri tek metafizika. Marrë në esencë kjo është krenari njerëzore e cila vjen në shprehje në pikëpamjen materialiste të botës, e cila vetëm shprehet në mënyrë plotësisht të veçant, krenaria njerëzore, me të cilën njeriu dëshiron të bëhet reflektim i hyjnorës-shpirtërorës, sipas të cilës ai dëshiron të bëhet vetëm qenie shtazarake më e lartësuar. Ky është ai ajo më e lartësuar. Shtrohet pyetja se në mes të çkahit ai është më i lartësuar? Kjo krenari e çon njeriun deri tek ajo që asgjë tjetër të mos pranojë përpos vetes. Kur pikëpamja shkencorë-natyrore ndaj botës kishte qëndruar tek e vërteta, kishte me qenë detyrë e saj gjithsesi që njeriut gjithnjë rishtazia t'ia rrënjos: Ti je më superior prej atyre qenieve të cilët mund t'ia krijosh vetes përfytyrimin. Konsekuncat e atij opinioni i cili sot dëshiron të jetë i

ekzakt “shkencor” në të vërtetë janë të atilla sa që e humbin njeriun. Por me të vërtetë, në kohën tonë ku është epoka në të cilën në mënyrë të veçant (pikërisht në fushën e njohjes) është i kryqëzuar, i vrar Jezu Krishti. Dhe derisa njerëzit mos të vijnë deri tek ajo që llojin e sotit të njohjes, e cila është e lidhur vetëm me epshorën, ta konsiderojnë varr të njohjes nga i cili duhet të del ringjallja, para kësaj njerëzimi nuk do të vijë deri tek ngirtja e ndjenjës dhe ndjenjave të tilla të cilat do të bëhen të pashkës.

Për këtë arsye duhet vetes t’ia pranojmë mendimet: Ekzistojnë legjendat mbi Pashkën i cili duhet të jetë në javën e parë pas hënës së plotë pranverore. Të drejtën për ta festuar ne sot Pashkën nuk e kemi nëse jemi njerëz të kulturës moderne. Si e fitojmë drejtën përsëri për këtë? Le t’i bashkojmë mendimet me Jezu Krishtin i cili është në varr, me Jezu Krishtin i cili në kohën e pashkës e fiton gurin mbi varr, i cili është futur në varr, e bashkojmë këtë mendim me tjetrin, se shpirti i njeriut duhet ta ndiej në vete gurin e varrit me njohjen e pastër të jashtme mekanike, dhe duhet të anoj ta mposht shtypjen e kësaj njohjeje për t’iu mundësuar të ketë njëlloj religjioni të vërtetë e jo vetëm: “Jo unë por shtaza më e lartësuar në mua”, por të jetë përsëri në gjendje të thotë: “Jo unë por Krishti në mua”.

Flitet se një shkencëtar në Angli kishte thënë: më me ëndje vetes iu kisha prezentuar se unë gradualisht me vullnetin tim personal, jam ngritur nga majmuni në

lartësitë e sotit, sesa si njeri ka zbritur nga “lartësit e hyjnisë” të dikurshme, siç ju ka dukur kundërshtarit të tij i cili nuk ka mundur të besoj shpjegimet ekzakte shkencore. Por pikërisht këto gjëra tregojnë sesa është e domosdoshme ta gjejmë rrugën nga rrëfimi: ‘Jo unë por shtaza plotësisht e zhvilluar në mua’ deri tek ajo tjetra: “Jo unë, por Krishti në mua”. Për ta kuptuar thënjën e Palit, tek tash duhet kërkuar. Tek atëherë, miqët e mi të dashur, është e mundur se një lajm i vërtetë i pashkës nga thellësia e shpirtit tonë të hy në vetëdijën tonë.